

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Mirëmbajtja dhe suporti për sistemet e platformës elektronike Oracle Fusion, arkivës elektronike, Fiskalizimet dhe Faturës elektronike, për një periudhë 2(dy) vjeçare”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- 48613000-8 - Menaxhim i të dhënave elektronike (edm),
- 30211300-4 - Platforma kompjuterike

VLERA E FONDIT LIMIT:

49,599,000 (dyzet e nëntë milion e pesëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë) Lekë pa TVSH, konvertuar në vlerën **497,682** (katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy) Euro pa TVSH, sipas kursit të këmbimit datë 10.09.2024 (1 EUR = 99.66 ALL).

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Procedura e prokurimit me objekt “Mirëmbajtja dhe suporti për sistemet e platformës elektronike Oracle Fusion, arkivës elektronike, Fiskalizimet dhe Faturës elektronike, për një periudhë 2(dy) vjeçare”, ka për qëllim mirëmbajtjen dhe konfigurimin e disa platformave që ndihmojnë ecurinë e punës së Autoritetit Kontraktor. Gjithashtu pjesë e kësaj procedure prokurimi është edhe trajnimi i punonjësve me programet e reja që do të sigurohen nga Kontraktori.

Për këtë arsye, ndarja e kësaj procedure në Lote dhe rrjedhimisht mundësia e lidhjes së kontratës me disa operatorë ekonomikë të ndryshëm, do të vështirësonte realizimin e kontratës, pasi operatorët ekonomikë të ndryshëm mund të paraqiten me oferta të cilat nuk përputhen me njëra-tjetrën, me qëllim mirëmbajtjen dhe konfigurimet përkatëse të kërkuara për këtë procedurë.

Autoriteti Kontraktor është institucion i rëndësisë së vecantë në sistemin elektro-energjitik shqiptar dhe cdo vonesë në realizimin e kontratës mund të shkaktojë dëme të mëdha në rrjetin e transmetimit kombëtar dhe ndërkombëtar.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 *Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë xhiro minimale vjetore të realizuar, për periudhën e 3 (tre) viteve të fundit financiare, të paktën 99,000,000 (nentedhjetë e nente milion) Leke.*

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si prove për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë vertetim nga Administrata Tatimore ku të tregohet xhiroja vjetore për vitet e sipërpermendura dhe kopje të certifikuara të bilanceve ku të paktën në dy bilance të fundit, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, kërkohej që OE ofertues të paraqese se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar ato në kohë dhe në përputhje me specifikimet teknike të kërkuara. Për këtë, OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe me këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros për tre vitet e fundit financiare të jete në masën 99,000,000 (nëntëdhjetë e nëntë milion) Leke, jo me e lartë se dyfishi i vlerës së parashikuar të kontratës, sipas parashikimeve të nenit 43/2/a të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, kontrata të ngjashme në një vlerë të pakten prej 19,000,000 (nëntëmbëdhjetë milion) Lekë pa TVSH.

Lidhur me këtë pikë:

Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohej vërtetimi të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 3, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë sasinë dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jete afër limitit maksimal dhe në këtë mënyrë, AK ka sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikojnë në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori ekonomik ofertues qe do te realizoje kete kontrate, duhet te jete i pajisur dhe te paraqese certifikatat perkatese te vlefshme te ISO-ve, te leshuara nga organizmat e vleresimit te konformitetit, te akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si me poshte:*

- *ISO 9001: Per menaxhimin e cilesise, qe ka lidhje me objektin e kontrates;*
- *ISO 27001: Per menaxhimin e sigurise se informacionit, objekti i se ciles te kete lidhje me objektin e prokurimit.*

Argumentimi: Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 44, të VKM-se Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe Ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se këto Certifikata duhet të jenë të leshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të leshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

Standarti i cilesise ISO 9001: eshte sot referimi i njohur ne nivel nderkombetar, per certifikimin e sistemit te menaxhimit te cilesise te kompanive te te gjithë sektoreve dhe te gjithë permasave. Ky kriter kerkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.

ISO 27001: - Ky standard është i nevojshëm për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Ky standard përfshinë kërkesat për vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve të sigurisë së informacionit të përshtatura për nevojat e organizatës, me qëllim që informacioni të mbetet i sigurtë dhe të mos çënohet siguria e sistemeve të saj nga sulmet kibernetike.

AK duhet te marre çdo mase te nevojshme per parandalimin dhe mos cenimin e veprimtarise se saj, ku per shkak te moscertifikimit te duhur te kontraktoreve, AK duhet te pezulloje ose te vonoje veprimtarine e saj, duke shkaktuar nje dem te madh ne sistemin elektro energjistik shqiptar, ku eshte edhe objekti i saj kryesor.

2.3.3 *Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese suportin ose autorizimin e prodhuesit/distributorit te autorizuar per objektin e prokurimit. Autorizimi duhet te permbaje te dhena te plota te prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme per Autoritetin Kontraktor ne rast verifikimi nga ana e tij.*

Argumentimi: Suporti i prodhuesit/distributorit te autorizuar, është nje dokument i rëndësishëm, pasi përvec se tregon origjinën e mallrave/sherbimit që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të tyre. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.4 *Operatori ekonomik ofertues duhet te kete certifikimet si me poshte:*

- *Sisteme Oracle ERP Cloud;*
- *Sisteme Oracle Supply Chain & Manufacturing;*
- *Infrastructure Cloud;*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikimet e marra nga prodhuesit e programeve dhe teknologjive qe po ofertojne, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Argumentimi: Sistemet kryesore ne projekt jane Cloud ERP; si dhe Sistemi i fiskalizimit ne Cloud. Lidhur me zbatimin dhe mirembajtjen e sistemeve te mesiperme, prodhuesit e programeve informatike te mirenjohur nderkomebtare sikurse Oracle apo edhe te ngjashem, kane ndertuar programe trajnimi dhe kontrolli te shoqerive te cilat mundet te kryejne sherbime qe lidhen me zbatimin apo mirembajtjen e ketyre sistemeve. Ne kuader te ketyre programeve prodhuesit vendosin kriteret teknike; organizative per burimet njerezore dhe per procedurat e brendshme te shoqerive. Keto programe/kushte ndertohen nga vete prodhuesit dhe ata ne kete menyre marrin persiper cilesine e sherbimeve te ofruara nga shoqerite. Ne shume raste, kalimi i certifikimeve i kualifikon shoqerite e IT si te autorizuar apo jo prej tyre per realizimin e sherbimeve te nderhyrjes, permiresimit apo perditesimit te sistemeve. Nese shoqerite nuk kane certifikime te prodhuesit (per sisteme apo modulet) cdo nderhyrje ne sistem rezikon perfundimin e kushteve te garancise apo te mirembajtjes se prodhuesit.

Per kete, certifikimet e mesiperme qe kane lidhje me Modulet apo sistemet qe kerkohej te prokurohet jo vetem qe perbejne nje nevojë per garantimin e cilesise se sherbimit, por ato jane direkt te lidhura edhe me kërkesat e prodhuesve per mirembajtjen. Nderhyrje ne sistem nga shoqeri te pa-certifikuara mundet te demotoje vete sistemin, te dhenat qe mbahen ne sistem dhe/ose ne kuadrin e sigurise se informacionit mundet te behet shkak per aksesin apo demtimin e informacionit ne persona apo drejtime te paautorizuara.

Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për të garantuar që Operatori Ekonomik ka mbështetjen e prodhuesit për të garantuar cilësinë e produkteve dhe furnizimin e tyre në kohë për përmbushjen me sukses të kontratës, duke garantuar funksionimin e sistemeve në kushtet e garancisë dhe pas saj. Certifikimet e mesiperme, garantojnë autoritetin Kontraktor që shërbimet e përfshira në kontratë do të levrohen janë në përputhje me kërkesat e shoqërive prodhuese.

Ky kriter është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 5 dhe 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar/ose të ketë kontratë bashkepunimi me një prodhues të certifikuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zhvillimin e softwar-ike për fiskalizimin. Zgjidhja software-ike e ofertuar duhet të jetë e certifikuar për veprimtarinë si mëposhte:

- *Me dhe pa para në dorë;*
- *Pa para në dorë, e-invoice;*
- *Faturë shoqëruese;*
- *Për regjistrimin e pagesave pa para në dorë të faturave elektronike.*

Për të vërtetuar këtë pikë, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin certifikatat e produktit për plotësimin e vepimtarive të fiskalizimit si mesiper dhe certifikatën e kompanisë ose kontratë bashkepunimi me një shoqëri të certifikuar për të ofruar shërbimin e fiskalizimit, ose certifikimet ekuivalente, lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre.

Argumentimi: Legjislacioni shqiptar, përcakton që sistemet e fiskalizimit duhet të jenë të Certifikuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve si dhe AKSHI. Në bazë të Ligjit Nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit, të qarkullimit”, neni 16, pika 1. Përcaktohet “Përpara fillimit të ushtrimit të veprimtarisë së ofrimit të zgjidhjeve software-ike ose shërbimeve të mirëmbajtjes në territorin e Republikës së Shqipërisë, prodhuesit dhe mirëmbajtësit e zgjidhjeve software-ike, duhet të regjistrohen në mënyrë elektronike në regjistrin e prodhuesve ose të mirëmbajtësve software-ike të AKSHI-t, duke përdorur platformën qendrore të faturave”.

Për këtë edhe kerkimi i certifikimit nga Tatimet dhe AKSHI, përben një detyrim ligjor.

Ky kriter mbështetet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/a, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë, personel Teknik, prej të paktën 3(tre) muajt e fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të diplomuar në degët e Inxhinierisë Elektronike,

Informatike, etj. qe do te angazhohet ne implementimin e projektit, duke pasur njohuri te kombinuar sipas kerkesave te meposhtme:

- *1 (nje) punonjes te certifikuar per zbatime sistemesh Oracle ERP*
- *1 (nje) punonjes te certifikuar per sisteme infrastrukture cloud*
- *1 (nje) punonjes te certifikuar per raportim BI*
- *1 (nje) punonjes te certifikuar per administrator databaze per administrimin e bases se te dhenave*

Shenim: Nje punonjes mund te kete me shume se nje certificate.

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 9.

Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Qellimi kryesor i projektit është zbatimi i sistemeve ERP cloud si dhe operimi dhe mirembajtja për periudhën e kontratës. Për realizimin e këtij shërbimi kërkohet që në secilën nga fushat kryesore të projektit, operatori ekonomik të përdorë personelin teknik të mjaftueshëm dhe të kualifikuar. Në këtë drejtim, prodhuesit e ndryshëm të sistemeve ERP kanë krijuar programe trajnimit dhe testimit të njohurive të specialisteve. Kalimi i këtyre programeve të certifikimit (të vetë prodhuesve) është një garanci që nderhyrjet në sistem për konfigurimin dhe vënien në punë të sistemeve, si dhe përgjatë periudhës së operimit do të kryhen në përputhje me kushtet teknike të përcaktuara nga këta prodhues. Mungesa e këtij certifikimi për personelin teknik që kryen nderhyrje në sisteme, në prodhues të ndryshëm përben edhe një arsye/kusht për ndërprerjen e garancisë së produktit. Për këtë, certifikimi i mesipërmi i personelit jo vetëm rrit garancinë e suksesit të projektit por përben edhe një kusht për operimin dhe mirembajtjen e tij në vazhdimësi.

Fushat e mesipërme të ekspertises si dhe numri i personelit të certifikuar, është kryer në bazë të komponenteve të projektit si dhe të masës së angazhimit të specialisteve. Në kërkesat për 2 personelin teknik, është pas parasysh nevojë që OE të ketë personelin të certifikuar edhe përgjatë periudhës së mos disponibilitetit të personelit kryesor.

Certifikimet argumentohet si vijon:

a) Implementimi i sistemeve ERP, kërkon njohuri specifike për cilat lidhet jo vetëm me njohjen e sistemeve ERP por edhe me njohjen e praktikave kontabel dhe operacionale të ndërmarrjeve. Certifikimi i këtij lloji garanton OE që sistemi do të zbatohet nga personelin teknik që ka kaluar kushtet e prodhuesve për specialiste të këtij lloji. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirembajtjen e sistemeve.

b) Ky projekt kërkon që shërbimet të marra të jetojnë në Cloud dhe për këtë është e nevojshme që të jetojnë pjesë e stafit të këtij specializimit në cloud. Këto njohuri janë specifike dhe të domosdoshme për zbatimin dhe mirembajtjen e sistemeve.

c) Implementimi i projektit, kërkon njohuri specifike ne fushen e BI. Certifikimi i ketij lloji garanton OE qe sistemi do te zbatohet nga personel teknik qe ka kaluar kushtet e prodhuesve per specialiste te ketij lloji.

d) Ky projekt kërkon qe te dhenat te jene te ruajtura ne baze te dhenash. Per kete eshte e nevojshme qe te jete pjese e stafit te pakten nje person qe ka aftesi ne “database”.

Ky kriter mbeshtetet ne pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.7 Ne funksion te plotesimit te Shtojces 9 “Formulari permbledhes i vetedeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet te jape te dhena te qarta si Emer, Mbiemer, Atesi, Amesi, Datelindje, Vendlindje, Numer Personal, si dhe kopje te skanuar te dokumentit te identifikimit (shqiptar ose te huaj), per Administratorin/Administratoret e shoqerise, Ortakun/Ortaket e shoqerise, perfaqesues te ndryshem te posacem te shoqerise, drejtues te ndryshem te shoqerise.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76/1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor OST sh.a. ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i ketyre personave kërkon te dhëna te sakta si emër, mbiemër, atesi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personi.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe Termat e References, jane hartuar duke marre ne konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, per mallrat dhe sherbimet objekt procedure prokurimi, duke perlllogaritur sasite e nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombetare dhe nderkombetare, sipas parashikimeve te nenit 36, te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” i ndryshuar.